



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 507 /18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković – Kryetar , z. Nuhi Paçarizi - Referues, dhe z. Blerim Dina Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Albi Company”shpk-Rahovec, ku i rekomanduar për dhënie të kontratës është OE NNP“Archiko.ing &Al-Group”shpk Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore” me nr. të prokurimit: 616-18-4828-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): KK - Prishtinë më datën 22.10.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Albi Company” Shpk – Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore” me nr. të prokurimit: 616-18-4828-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): KK - Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK KK Prishtinë , lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore” me nr. të prokurimit: 616-18-4828-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): KK - Prishtinë.” dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Albi Company” Shpk – Rahovec, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 02.07.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 23.07.2018

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Albi Company” Shpk – Rahovec, me dt: 16.08.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 17.08.2018 ka marrë vendim që të aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e OE: “Albi Company” Shpk – Rahovec.

Operatori ekonomik ankues: “Albi Company” Shpk – Rahovec, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 21.09.2018 me nr. 507 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore” me nr. të prokurimit: 616-18-4828-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): KK - Prishtinë”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 6, 56, 59, 41 RrUOPP, 60 28, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.09.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 01.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues: “Albi Company” Shpk – Rahovec, në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti te prokurimit,

konstaton si në vijim:

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se nuk ka plotësuar piken 9.1 dhe 9.2 kapacitetin teknik dhe profesional për renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore në vlerë 50,000.00 Euro, pasi që kontratat e pranuar nga ana e AK-së si renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore nuk janë të natyrës siç është kërkuar nga AK, pasi që nuk janë Renovime, ndërhyrje/konservues restauruese, por janë rregullime të oborreve me kubëza betoni të cilat nuk janë Renovim, për më tepër nuk janë ndërhyrje në asete të trashëgimisë kulturore, shih shkresën.

Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore nënkupton ndërhyrje në një aset të trashëgimisë kulturore, aset i cili është në listën e aseteve të trashëgimisë kulturore të MKRS qofte atyre nën mbrojtje të përkohshëm apo të përhershëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar listën kontratave të realizuar në tri vitet e fundit deri në datë e publikimit të njoftimit, mirëpo projektet e prezantuar në këtë listë si projekte të trashëgimisë kulturore nuk janë në harmoni me kërkesën e AK në FDT nën 9.1 dhe 9.2, pasi këto projekte të prezantuar në këtë listë nuk janë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshëm sipas Vendimit nr. 65/2017 të MKRS, të cilët kanë miratuar e Listën e Trashëgimisë kulturore për mbrojtjen e përkohshëm e për periudhën 10.10.2017 – 10.10.2018, (meqë kjo është një listë shumë e gjatë dhenë se ka ndodh të mos e kam vrenjtur lus AK të argumentoj para PSH), dhe projektet e prezantuar në këtë listë janë projekte të rregullimit dhe të ndriçimit dhe konsideroj se nuk janë ndërhyrje në asete të trashëgimisë kulturore, duke u bazuar në nenin 2.1 të FDT-së dhe FPP 45261910-6 – (Riparim të çatave) si dhe duke pasqyruar se kontratat e prezantuara nga OE fitues nuk e kanë të bashkangjitur Aneksin II – paramas dhe parallogarit - për të shikuar punët që janë kryer në këto kontrata, si në vijim:

Lista e kontratave të OE fitues NNP "Arhiko.ing"

Nr.	Data e nënshkruar	Nr i Prok.Aut. Kont.	Titulli Çmimi.	Plani Dinamik.	Komenti i Autorit. Kontraktues
1.	28.10.2018	0095982	UNDP Construction Works (Renovation of Catholic Church Former Seat of The Diocese Ferizaj)	91,211.64€	Kontrata është realizuar vetëm 80 % Nuk është marrë parasysh sepse nuk është përfunduar 100%.

2.	14.10.2016	0095982	UNDP	Construction Works SerbianOrthodoxCemeteryChapelRenovation in Lipjan Minicipality	29,863.65€	Pranuar
3	25.10.2016	0095982	UNDP	Constructionworksforcomplexofbuldings “Mulla Vesel Guta” (xhamia e madhe) Mosque and SOC st. UrosLighetnin and YardUpgrading (listedCulturalheritage) in Ferizaj	19,251.00€	Pranuar
4	28.09.2016	0095982	UNDP	Lot1 – Town Mulla Sherif Ahmeti MosqueYardUpgrading in Lipjan	41,442.00€	Pranuar
Total					60,693.00€	

Eksperti shqyrtues bazuar ne këto fakte sqaron si ne vijim:Kërkesat për sqarime shitesë ne bazë të nenit 59 dhe 72 te LPP-se, është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te ofertave te kërkoj sqarime me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit te tyre, ne mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda afatit ligjore te caktuar kohor, me kusht qe kërkesat e tilla te bëhen ne përputhje te plote me parimet e trajtimit te barabarte dhe transparencës. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës ne ankese ne këtë pike janë te qëndrueshme.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se projekt menaxheri – Ing. i dip. i arkitekturës nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës z. Veton Maloku, nuk ka 3 vite përvojë pune dhe nuk posedon përvojë ne restaurime/konservim te objekteve te trashëgimisë kulturore, pasi ka mospërputhje ne mes CV dhe referencës nga OE PMN shpk pasi ne referencë te datës 25.12.2017, cekte se ka qene i angazhuar si ekspert i jashtëm, kurse ne referencën e datës 10.02.2018, ceket se ka qene i angazhuar me kontratë mbi vepër si dhe nuk caktohet periudha e angazhimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar ne CV e z. Veton Maloku, disa projekte te trashëgimisë kulturore nga kompania PMN shpk si ne vijim:

Ndërtimi – modelimi i shtatores se Isa Boletinit Mitrovice 2012;

Ndërtimi i lapidareve dhe rregullimi i varrezave – 2013;

Sanimi i dëmeve ne memorialin e varrezave ne Marin Skenderaj 2015;

Ndërtimi i varrezave te qytetit te Junikut 2015;

Ndërtimi i busteve te dëshmoreve Rahovec 2016;

Rregullimi i varrezave të dëshmoreve në Prilep 2017, si dhe ka prezantuar edhe disa projekte të tjera nga viti 2010 deri në vitin 2017, gjithashtu është prezantuar kopja e diplomës dhe kontrata e punës. Si dhe ka prezantuar referencën nga kompania PMN shpk e datës 10.02.2018, për z. Veton Maloku, dhe potencon se ka qene projektant/mbikëqyrës me kontratë mbi vepër në projektet e trashëgimisë kulturore, të cekura si më lart. Prandaj, në bazë të analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës në ankese në këtë pikë janë tepa qëndrueshme, pasi konsideroj se AK ka vepruar në pajtim me nenin 59.4 të LPP-se

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se inxhinierin e ndërtimtarisë – Konstruktive i prezantuar, nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës z. Shefqet Morina, nuk ka 3 vite përvojë pune dhe nuk posedon përvojë në restaurime/konservim të objekteve të trashëgimisë kulturore, pasi ka mospërputhje në mes CV dhe referencës nga OE PMN shpk pasi në referencë të datës 10.02.2018, cekte se ka qene i angazhuar me kontratë mbi vepër dhe nuk caktohet periudha e angazhimit. Si dhe pretendimit se projektet e trashëgimisë kulturore të cekura në CV dhe reference janë fiktive.

Eksperti shqyrtues sqaron, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar në CV e z. Shefqet Morina, disa projekte të trashëgimisë kulturore nga kompania PMN shpk si në vijim:

Ndërtimi i lapidareve dhe rregullimi i varrezave – 2013;

Punimi i shtatores Ahmet Delia në Prekaz – 2014;

Sanimi i dëmeve në memorialin e varrezave në Marin Skenderaj- 2015;

Realizimi i skulpturës i shtatores së ambasadorit William Walkes në kompleksin memorial Masakra e Reçakut në Reçak PMN shpk – 2016; si dhe ka prezantuar edhe disa projekte të tjera nga viti 2010 deri në vitin 2017, gjithashtu është prezantuar kopja e diplomës dhe kontrata e punës. Prandaj, në bazë të analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës në ankese në këtë pikë janë tepa qëndrueshme, pasi konsideroj se AK ka vepruar në pajtim me nenin 59.4 të LPP-se.

Sqarim: Lidhur me pretendimet rreth falsifikimit – fiktive të disa dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i shpallur fituese, pretendimet e tilla duhet të parashtrihen tek organet kompetente të cilat kanë kompetencë të hetojnë rastet e tilla.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Mjeshtri i drurit i prezantuar, nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës z. Xhavit Morina, nuk ka pasuar dëshmi certifikatë apo diplome për të dëshmuar që është mjeshtër i zdrukthëtarisë, - drurit siç është kërkuar në dëshminë 2 që duhet dorëzuar kopje e diplomave, CV dhe kontrata të punës.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK ne kërkesën për rishqyrtim me datë 16.08.2018 pranon si pjesërisht te bazuar ankesën e OE ankues duke kthyer ne rivlerësim. AK formon komisionin e ri-vlerësimit, tjetër komisioni nga komisioni i pare dhe me datë 28.08.2018, kërkon sqarim nga OE NNP “Arhico.ing”, lidhur me mjeshttrin e drurit dhe te dëshminë për kualifikimin shkollorë - kopjen e diplomës. Në CV e prezantuar nga OE NNP “Arhico.ing” përzh. Xhavit Morina, ne CV nuk prezantohet apo dëshmohet se ka diplome te zdrukthëtarisë – drurit, por tek pjesa e edukimit po citoj:2007-2011 – Technician (Profesional TechnicianHighSchool – Malisheva) , kurse tek eksperiencia e punës – present po citoj: Technician, Welding Specialist (NNP “Arhico.ing”, Prishtine).

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, eksperti shqyrtues sqaron,ne baze te analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës ne ankese ne këtë pike qëndron, pasi AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 dhe 72 si dhe RRUOPP neni 39.8 po citoj:

CV e dorëzuar nuk përmbush kërkesat Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtutjeshëm 69

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE “Euro Projekt” shpk është i pa përgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar kërkesat 1 dhe 2 te FDT-se.

Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron si ne vijim: Është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit/Ri-vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve me kusht që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, duke marr parasysh Aneksin 1 në dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin te operatorit ekonomik ankues se autoriteti kontraktues ka shkelje te nenit 1, 7, 56, 59, 60të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron lidhur me këtë pretendim te OE ankues qëndron bazuar dhenjëkohësisht nuk është respektuar edhe nenin 7 par. 1 të LPP-së,po citoj: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore te parashtruara ne ankese nga OE ankues, sqaron se ky aktivitet i prokurimit duhet te rivlerësohet dhe njëherit rekomandoj AK-se qe edhe një here ta bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, dhe AK te

respektoj ne tersi dispozitat ligjore te LPP-se lidhur me këtë aktivitet te prokurimit konform njoftimin për kontratë dhe dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se autoritetit kontraktues është i obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne nenin 6 të LPP-së. Po ashtu, eksperti shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike.

Ne fund eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore te parashtruara ne ankese nga OE ankues, vlerëson se pretendimet e lartpërmendura te OE ankues janë te qëndrueshme dhe se ky aktivitet i prokurimit duhet te kthehet ne rivlerësim me mënyrë qe te behet verifikimi i dëshmimeve te lartpërmendura dhe njëherit eksperti shqyrtues, i rekomandon AK-se qe gjate rivlerësimit te këtë parasysh nenin 1, 7, 59 dhe 60 te LPP-së.

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, rekomandojmë që ankesa e OE: "AlbiCompany" Shpk – Rahovec, për tenderin e AK – "KK – Prishtinë", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore", me nr. të prokurimit: 616-18-4828-5-2-1, të aprovohet site bazuara(për arsyen që u cek tek përgjigjet në pretendimet 1,4,6) dhe të njëjtin tender rekomandojmë Autoritetin Kontraktues, që të anuloj njoftimin për dhënien të kontratës dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.10.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.10.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, Eksperti shqyrtues-teknik, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi OE ankues z.Halili deklaroi: Eksperti në kundërshtim me kërkesat e FDT ka pranuar kontrata që nuk i përkasin lëmisë së kërkuar për vitet 2014-2015-2016 i OE ankues Eksperti profesional thotë se askund në dosjen e tenderit nuk është kërkuar kontratë për ujësjellës por thotë që është kërkuar lëmia e kërkuar.

Atëherë shtrohet pyetja çka nënkupton lëmia e kërkuar për ekspertin dhe ç'far natyre është ky aktivitet i prokurimit, ujësjellës , ndërtim të lart, asfaltim apo mirëmbajtje, pasi që fakte janë të qarta se kontratat janë për lëminë e kërkuar dh enë këtë rast lëmia kërkuar është ujësjellësi e jo lëmi tjetër , por ky ekspert është munduar të shtremboj kërkesën për faktet e prezantuara.

Pasi që Fana&Lala dhe grupi tjetër Alfa Ing&AlTrade nuk kanë kontrata të lënmisë së kërkuar - për ujësjellës. Ujësjellësi dallon nga dërtimet e larta dhe ndërtimet tjera.

Si mund të merret kontratë e lëmisë së kërkuar psh “mirëmbajtja e rrugëve “ apo Ndërtimi i rrugëve. Këtu është kërkuar lëmi e kërkuar e jo kontrata të ngjashme, mirëpo edhe të kërkohej lëmia e ngjashme nuk është lëmi e ngjashme mirëmbajtja rrugëve apo asfaltimi apo ndërtimi i objekteve.

Pra nuk mund të interpretohet sipas dëshirës kërkesa për kontrata e realizuara në lëminë e kërkuar dhe nuk mund të zgjerohet përtej kërkesës së AK-së.

Eksperti në kundërshtim me rregullat e tenderit ka pranuar kontrata edhe të viteve 2010 dhe 2012. Si shembull nga Lala shpk ndërtimi i ujësjellësit rajonal Novosellë – Shishtavec – Borje e nënshkruar me 31.07.2012, ku afati maksimal; për punime ka qenë 12 muaj. Pastaj kontrata ndërtimi i ujësjellësit në Tregtabni madhe Metaliaj e nënshkruar me 05.08.2012, ndërtimi i ujësjellësit në Divijak e nënshkruar me 02.03.2010 me afat punimeve 7 muaj.

Në qoftë se këto kontrata i zbrisim nga lista e kontratave të OE të rekomanduar për kontratë së bashku ata nuk arrijnë as vlerën 1.5 milion euro kontrata e në dosje është kërkuar 3,032,736€ punë të lëmisë së kërkuar. Të gjitha këto pretendime i kemi shtruar në ankesë, kemi bashkangjitur kopje të kontratave mirëpo është e çuditshme ekspertiza dhe trajtimi i pretendimeve ankimore në këtë mënyrë.

Sa për njoftim OE i rekomanduar për kontratë është shpall i papërgjegjshëm me vendimin e OSHP nr.263/16 për të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe për të njëjtat pretendime ankimore për punë të lëmesë së kërkuar.

OE Lala shpk ka ofrua vetëm pasqyrat financiare të pa shoqëruara me qarkullim bankarë apo deklarata vjetore të dorëzuar në ATK. Si dëshmi procesverbali i pranimit të dokumenteve nga KK Dragash pas qasjes zyrtare.

OE Alfaing&Al Trade nuk ka ofruar fare marrëveshje për gurthyes por vetëm një kontratë vjetore për qera të mjeteve themelore që kjo nuk nënkupton marrëveshje për furnizim me zhavorr.

Kërkojmë nga paneli të analizoj pretendimet tona që janë plotësisht të bazuara me fakte, po ashtu kërkojmë edhe nga eksperti të prezantoj dëshmitë në cilat bazohet në këtë ekspertizë jo profesionale dhe subjektive.

Eksperti nuk është përgjigjur në pretendimet tona duke shkel neni 113.1 të LPP ku janë caktuar detyrat nga OSHP.

Po ashtu ka shkel neni 114.1 të LPP pasi që nuk ka shqyrtuar gjitha pretendimet ankimore të përfshira në ankesë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i AK-KK Dragash z.Ismaili deklaroj:
Ne pajtohemi me ekspertin shqyrtues të OSHP.

Sa i përket kompanisë ankuese, Fanaj Injineriing ka konkurruar me version elektronik, ashtu që dokumentet janë diku mbi 500 faqe. Dhe i kanë të renditura sipas viteve, kështu që eksperti ka pas komplet dokuemtacionin , ai ka pas qasje në E prokurim por edhe i kemi ofruar CD ku ka pas qasje në këto informata. Kur Puna ka kërkuar qasje po ashtu kanë pas qasje në gjitha këto dokumente.

Referenca për 3 milion, kur kemi shkruan tenderin nga KRPP është kërkuar natyrë e ngjashme, dhe nuk kemi mundur ta kufizojmë vetëm në ujësjellës.

Fanaj ka hyrë në konzorcium pasi nuk ka pas referenca të mjaftueshme si e vetme.

Në pyetjen e kryetarit, Anëtari i panelit drejtuar përfaqësuesit të AK-së se pasi kontrata ka qenë e natyrës së ngjashme, a mundet saktësisht të na sqaroi përfaqësuesi i AK-së si ka qenë kërkesa për kontrata.

Në përgjigje z.Ismaili deklaroj:Për gjitha projektet kur bëjmë shpalljet kërkohet referenca për natyrë të ngjashme. Në këtë rast është kërkesa “kontrata të realizuara jo më pak se 3 milion të lëmisë së kërkuar”.

Në pyetjen e Anëtarit të panelit drejtuar përfaqësuesit të AK-së se a keni pranuar edhe referencat e viteve 2012.

Përfaqësuesi i AK-së z.Ismaili jep këtë përgjigje : kemi pranuar vetëm sipas viteve të kërkuar 2014-2015-2016.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Halili dkelaroj: OE në listë të kontratave ka shënuar se janë përfunduar në vitin 2014, fjala është për kontratat që kanë të bëjnë me ujësjellës, mirëpo këto siç ceka nuk janë të vitit 2014. Po ashtu grupi tjetër ka kontrata për ndërtime etj, që nuk janë lëmi e kërkuar propozojmë panelit të aprovoj ankesën si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK-KK Dragash z.Ismaili deklaroj: Ne si AK kemi respektuar dispozitat ligjore dhe kemi përzgjedhur OE më të lirë, pasi është dallimi shumë i madh mes OE ankues dhe OE të rekomanduar për kontratë për rreth 430,000€.

I propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK si të bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar piken 9.1 dhe 9.2 kapacitetin teknik dhe profesional për renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore në vlerë 50,000.00 Euro, pasi që kontratat e pranuar nga ana e AK-së si renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore nuk janë të natyrës siç është kërkuar nga AK, pasi që nuk janë Renovime, ndërhyrje/konservues restauruese, por janë rregullime të oborreve me kubëza betoni të cilat nuk janë Renovim, për më tepër nuk janë ndërhyrje në asete të trashëgimisë kulturore, shih shkresën. Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore nënkupton ndërhyrje në një aset të trashëgimisë kulturore, aset i cili është në listën e aseteve të trashëgimisë kulturore të MKRS qofte atyre nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme.

Paneli shqyrtues sqaron, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar listën kontratave të realizuar në tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit, mirëpo projektet e prezantuar në këtë listë si projekte të trashëgimisë kulturore nuk janë në harmoni me kërkesën e AK në FDT nën 9.1 dhe 9.2, pasi këto projekte të prezantuar në këtë listë nuk janë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme sipas Vendimit nr. 65/2017 të MKRS, të cilët kanë miratuar Listën e Trashëgimisë kulturore për mbrojtjen e përkohshme e për periudhën 10.10.2017 – 10.10.2018.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se Listën e Trashëgimisë kulturore për mbrojtjen e përkohshme e për periudhën 10.10.2017 – 10.10.2018, si dhe duke pas parasysh se kontratat e prezantuara nga OE fitues nuk e kanë të bashkangjitur Aneksin II – paramas dhe parallogarit - për të shikuar punët që janë kryer në këto, konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit duhet të veprojë në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së në mënyrë që të sqarohen kontratat e kontestuara nga ana e OE ankues dhe të vërtetohet se dëshmitë e ofruara nga ana e operatorit ekonomik të rekomanduara për kontratë sa i përket kësaj pike a janë në pajtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se kërkesat për sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-se, është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të kërkojë sqarime me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tyre, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët

ekonomik që të dorëzojnë plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda afatit ligjor të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se projekt menaxheri – Ing. i dip. i arkitekturës nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës z. Veton Maloku, nuk ka 3 vite përvojë pune dhe nuk posedon përvojë në restaurime/konservim të objekteve të trashëgimisë kulturore, pasi ka mospërputhje në mes CV dhe referencës nga OE PMN shpk pasi në referencë të datës 25.12.2017, cekte se ka qene i angazhuar si ekspert i jashtëm, kurse në referencën e datës 10.02.2018, ceket se ka qene i angazhuar me kontratë mbi vepër si dhe nuk caktohet periudha e angazhimit. Paneli shqyrtues konstaton, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar në CV e z. Veton Maloku, disa projekte të trashëgimisë kulturore nga kompania PMN shpk si në vijim:

Ndërtimi – modelimi i shtatores së Isa Boletinit Mitrovice 2012;

Ndërtimi i lapidareve dhe rregullimi i varrezave – 2013;

Sanimi i dëmeve në memorialin e varrezave në Marin Skenderaj 2015;

Ndërtimi i varrezave të qytetit të Junikut 2015;

Ndërtimi i busteve të dëshmoreve Rahovec 2016;

Rregullimi i varrezave të dëshmoreve në Prilep 2017, si dhe ka prezantuar edhe disa projekte të tjera nga viti 2010 deri në vitin 2017, gjithashtu është prezantuar kopja e diplomës dhe kontrata e punës. Si dhe ka prezantuar referencën nga kompania PMN shpk e datës 10.02.2018, për z. Veton Maloku, dhe potencon se ka qene projektant/mbikëqyrës me kontratë mbi vepër në projektet e trashëgimisë kulturore, të cekura si më lart. Prandaj, në bazë të sqarimeve të dhëna si më lart paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimet e ankuesit në këtë pikë sepse i njëjti operator ekonomik e ka plotësuar kërkesën e AK-së për këtë pikë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se inxhinierin i ndërtimtarisë – Konstruktive i prezantuar, nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës z. Shefqet Morina, nuk ka 3 vite përvojë pune dhe nuk posedon përvojë në restaurime/konservim të objekteve të trashëgimisë kulturore, pasi ka mospërputhje në mes CV dhe referencës nga OE PMN shpk pasi në referencë të datës 10.02.2018, cekte se ka qene i angazhuar me kontratë mbi vepër dhe nuk caktohet periudha e angazhimit. Si dhe pretendimit se projektet e trashëgimisë kulturore të cekura në CV dhe reference janë fiktive. Paneli shqyrtues konstaton, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar në CV e z. Shefqet Morina, disa projekte të trashëgimisë kulturore nga kompania PMN shpk si në vijim:

Ndërtimi i lapidareve dhe rregullimi i varrezave – 2013;

Punimi i shtatores Ahmet Delia ne Prekaz – 2014;

Sanimi i dëmeve ne memorialin e varrezave ne Marin Skenderaj- 2015;

Realizimi i skulpturës i shtatores se ambasadorit William Walkes ne kompleksin memorial Masakra e Reçakut ne Reçak PMN shpk – 2016; si dhe ka prezantuar edhe disa projekte te tjera nga viti 2010 deri ne vitin 2017, gjithashtu është prezantuar kopja e diplomës dhe kontrata e punës. Prandaj, ne baze te analizës dhe sqarimeve te dhëna si me lart paneli shqyrtues konstaton se pretendimet e palës në ankese ne këtë pike janë te pa qëndrueshme.

Paneli shqyrtues Lidhur me pretendimet e ankuesit rreth falsifikimit – fiktive te disa dokumentacioneve te dorëzuara nga OE i shpallur fituese, konsideron se pretendimet e tilla duhet te parashtrohen tek organet kompetente të cilat kane kompetencë te hetojnë rastet e tilla.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Mjeshtri i drurit i prezantuar, nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës z. Xhavit Morina, nuk ka pasuar dëshmi certifikatë apo diplome për te dëshmuar qe është mjeshtër i zdrukthëtarisë, - drurit siç është kërkuar ne dëshminë 2 qe duhet dorëzuar kopje e diplomave, CV dhe kontrata te punës.

Paneli shqyrtues sqaron se AK ne kërkesën për rishqyrtim me datë 16.08.2018 pranon si pjesërisht te bazuar ankesën e OE ankues duke kthyer ne rivlerësim. AK formon komisionin e ri-vlerësimit, tjetër komisioni nga komisioni i pare dhe me datë 28.08.2018, kërkon sqarim nga OE NNP “Arhico.ing”, lidhur me mjeshterin e drurit dhe te dëshminë për kualifikimin shkollorë - kopjen e diplomës. Në CV e prezantuar nga OE NNP “Arhico.ing” për z. Xhavit Morina, ne CV nuk prezantohet apo dëshmohet se ka diplome te zdrukthëtarisë – drurit, por tek pjesa e edukimit po citat: 2007-2011 – Technician (Profesional Technician High School – Malisheva) , kurse tek eksperienca e punës – prezent po citat: Technician, Welding Specialist (NNP “Arhico.ing”, Prishtine). Paneli shqyrtues Duke u bazuar ne fakte te prezantuar nga ana e ekspertit shqyrtues profesional qe i ka pranuar ne shqyrtim, konstaton se pretendimi i palës ne ankese ne këtë pike qëndron, pasi AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 dhe 72 si dhe RRUOPP nenin 39.8 citat: CV e dorëzuar nuk përmbush kërkesat Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtutjeshëm 69.

Paneli shqyrtues konstaton se për aktivitetin e prokurimit në fjalë AK-ja, nuk ka respektuar nenin 59 dhe 72 të LPP-së, andaj me rastin e rivlerësimit AK-ja duhet të ketë parasysh nenin 59,72 të LPP , duke e bërë vlerësimin e ofertave në bazë të kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate si dhe pecifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1. Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti

kontraktues në aktivitet e prokurimit duhet te ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, si dhe nenin 6 dhe 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK-Prishtinë

1x1 OE- “Albi Company” Shpk

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.